

Rregullorja

Për

Përfshirjen në Bllok të Kategorive të Marrëveshjeve Vertikale dhe Praktikave të Bashkërenduara¹

Neni 1

Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përfshin ato kategori marrëveshjesh vertikale që kanë të bëjnë me blerjen ose shitjen e produkteve, ku këto marrëveshje janë të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve jo-konkurrese, ndërmjet konkurrentëve të caktuar apo ndërmjet disa bashkimeve të caktuara të shitësve të produkteve.
2. Nuk përfshihen në fushën e zbatimit ato marrëveshje vertikale të cilat plotësojnë kushtet e nenit 4 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”(në vijim “ligji”). Në vlerësimin individual të marrëveshjeve duhet të merren parasysh disa faktorë dhe në veçanti struktura e tregut, e parë nga këndvështrimi i furnizuesit dhe/ose blerësit/shpërndarësit.
3. Disa kategori marrëveshjesh vertikale mund të përmirësojnë efikasitetin ekonomik brenda zinxhirit të prodhimit, ose shpërndarjes, duke lehtësuar bashkëpunimin midis ndërmarrjeve pjesëmarrëse. Gjithashtu, këto marrëveshje mund të çojnë në një zvogëlim të kostos së transaksionit dhe shpërndarjes, maksimizimin e shitjeve dhe niveleve të investimeve.
4. Mundësitë që efekte të tilla efikasitet-ritëse të ndikojnë në çdo element anti-konkurrese, për shkak të kufizimeve të përfshira në marrëveshjet vertikale, varen nga shkalla e *fuqisë së tregut* të palëve në marrëveshje.
5. Në fushën e zbatimit të kësaj rregulloreje nuk përfshihen ato marrëveshje vertikale që përmbajnë kufizime, të cilat ka të ngjarë të kufizojnë konkurrencën dhe t’i sjellin dëme konsumatoreve. Në veçanti, marrëveshjet vertikale që përmbajnë lloje të caktuara të kufizimeve të rënda të konkurrencës duhet të përjashtohen nga përfitimet e përjashtimit në bllok të përcaktuara në këtë Rregullore, pavarësisht pjesës së tregut të ndërmarrjeve.

Neni 2

¹ **32010R0330**; Rregullorja e Komisionit nr 330/2010 e datës 20 Prill 2010 mbi zbatimin e nenit 101/3 të Traktatit të Funkcionimit të BE-së për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara

Përkufizime

1. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Marrëveshje Vertikale", nënkupton një marrëveshje, apo praktikë të bashkërenduar, lidhur ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve, ku secila prej tyre vepron, për qëllimet e marrëveshjes ose praktikës së bashkërenduar, në një nivel të ndryshëm të zinxhirit të prodhimit ose të shpërndarjes, dhe në lidhje me kushtet në të cilat palët mund të blejnë, të shesin ose rishesin produkte ose shërbime të caktuara;
- b) "Kufizim Vertikal" nënkupton kufizimin e konkurrencës në një marrëveshje vertikale që është objekt i nenit 4 të ligjit;
- c) "Ndërmarrje Konkurruese" nënkupton një konkurrent aktual ose potencial;
 - 1) "Konkurrent Aktual" nënkupton një ndërmarrje që është aktive në të njëjtin treg përkatës;
 - 2) "Konkurrent potencial" nënkupton një ndërmarrje, e cila në mungesë të një marrëveshje vertikale, mundet mbi baza reale dhe jo thjeshtë teorike, që në rastin e një rritjeje të vogël por të përhershme të çmimeve, të jetë në gjendje të ndërmarrë brenda një periudhe të shkurtër kohe, investimet e nevojshme shtesë ose kosto të tjera të nevojshme këmbyses, për të hyrë në tregun përkatës;
- d) "Detyrim jo-konkurues" nënkupton çdo detyrim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që e detyron blerësin të mos prodhojë, blejë, shesë apo rishesë produkte, të cilat konkurrojnë me produktet e kontraktuara, ose çdo detyrim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të blerësit për të blerë nga furnizuesi ose nga një ndërmarrje tjetër e caktuar nga furnizuesi më shumë se 80% të blerjeve totale të produkteve kontraktues të blerësit dhe zëvendësuesve të tyre në tregun përkatës, të llogaritur në bazë të vlerës ose praktikave standarde të industrisë, referuar volumit të blerjeve të tyre në vitin e kaluar kalendarik;
- e) "Rrjet Përzgjedhës Shpërndarje" nënkupton një rrjet shpërndarjeje, ku furnizuesi merr përsipër të shesë produktet e kontraktuara, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, vetëm shpërndarësve të përzgjedhur në bazë të kriterëve të veçanta dhe ku këta shpërndarës marrin përsipër të mos tu shesin produkte shpërndarësve të paautorizuar brenda territorit që është rezervuar nga furnizuesi;
- f) "Të drejtat e pronësisë intelektuale" përfshijnë të drejtat e pronësisë industriale, "know-how", të drejtën e autorit dhe të drejtat e fqinjësisë;
- g) "Know-How" nënkupton një paketë informacionesh praktike të pa-licensuara, që janë rezultat i eksperiencës dhe testimeve dhe duhet të jenë:
 - 1) "sekret" do të thotë jo gjerësisht i njohur dhe lehtësisht i arritshëm;
 - 2) "thelbësor/i rëndësishëm" do të thotë i rëndësishëm dhe i nevojshëm për blerësin për t'u përdorur, për të shitur ose rishitur produktet e kontraktuara;

- 3) *"i identifikueshëm"* do të thotë se është përshkruar në mënyrë të plotë dhe të qartë aq sa të bëjë të mundur verifikimin e plotësisimit të kritereve të fshehtësisë dhe rëndësisë;
- h) *"Blerës"* përfshin një ndërmarrje e cila, sipas një marrëveshjeje sipas nenit 4 të ligjit, shet produkte në emër të një ndërmarrje tjetër;
- i) *"Klient i blerësit"* nënkupton një ndërmarrje e cila nuk është palë në marrëveshje, e cila blen produktet e kontratës nga një blerës që është palë e marrëveshjes.
- j) *"Ndërmarrje e lidhura"* nënkupton ato ndërmarrje, të cilat drejtpërdrejtë ose jo, kanë fuqinë të:
- i) ushtrojnë më shumë se gjysmën e të drejtave të votës, ose
- ii) caktojnë më shumë se gjysmën e anëtarëve të organeve drejtuese të ndërmarrjes, ose
- iii) menaxhojnë veprimtarinë e ndërmarrjes;

Neni 3

Përfshirja nga zbatimi i nenit 4 të ligjit

1. Neni 4 i ligjit nuk do të zbatohet për marrëveshjet vertikale në masën që këto marrëveshje përmbajnë kufizime vertikale.
2. Përfshirja e parashikuar në paragrafin 1 do të zbatohet për marrëveshjet vertikale që janë lidhur ndërmjet një bashkimi ndërmarrjesh dhe anëtarëve të tij, ose ndërmjet këtij bashkimi dhe furnizuesve të tij, vetëm nëse të gjithë këta antarë janë shitësit me pakicë të produkteve dhe kur asnjë anëtar individual i bashkimit të ndërmarrjeve, së bashku me ndërmarrjet e lidhura, nuk e tejkalon xhiron vjetore 200 milion lekë. Këto lloje marrëveshjesh vertikale janë objekt i kësaj Rregulloreje.
3. Përfshirja e parashikuar në paragrafin 1 do të zbatohet për marrëveshjet vertikale që përmbajnë dispozita, të cilat lidhen me përdorimin nga blerësi të të drejtave të pronësisë intelektuale, me kusht që këto dispozita të mos jenë objekt kryesor i marrëveshjeve të tilla dhe të lidhen direkt me përdorimin, shitjen ose rishitjen e produkteve nga ana e blerësit ose konsumatorëve të tij. Përfshirja zbatohet vetëm nëse, në lidhje me kontratën e produkteve, këto dispozita nuk përmbajnë kufizime të konkurrencës që kanë të njëjtin objekt si kufizimet vertikale, të cilat nuk janë të përfshiruara sipas kësaj Rregulloreje.
4. Përfshirja e parashikuar në paragrafin 1 nuk zbatohet për marrëveshjet vertikale të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve konkurruese. Megjithatë, ai do të zbatohet kur ndërmarrjet konkurruese lidhin një marrëveshje vertikale jo-reciproke dhe:
 - a) furnizuesi është një prodhues dhe një shpërndarës i mallrave, ndërsa blerësi është një shpërndarës dhe jo një ndërmarrje konkurruese në nivelin e prodhimit, ose

- b) Furnizuesi është një ofrues i shërbimeve në disa nivele tregtimi, ndërkohë që blerësi siguron produktet e veta në nivelin e shitjes me pakicë dhe nuk është një ndërmarrje konkurruese në nivelin e tregtimit, ku ai blen shërbimet e kontraktuara.
5. Kjo rregullore nuk zbatohet për marrëveshjet vertikale të cilat bien ndesh me kuadrin e çdo rregulloreje tjetër përjashtimi në bllok, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në një rregullore të tillë.

Neni 4

Kufiri i pjesës së tregut

1. Përjashtimi, i parashikuar në nenin 3, të mësipërm, do të zbatohet vetëm atëherë (dhe me përmbushjen e kushtit) kur pjesa e tregut, e cila zotërohet prej furnizuesit, nuk tejkalon 30% të tregut përkatës, në të cilin ai shet mallrat/shërbimet e kontraktuara dhe njëkohësisht, kur pjesa e tregut e zotëruar nga blerësi, nuk tejkalon 30% të tregut përkatës, në të cilën ai blen mallrat/shërbimet e kontraktuara.
2. Në zbatim të pikës 1, të mësipërme, në kushtet e një marrëveshjeje shumëpalëshe, kur një ndërmarrje blen produkte të kontraktuara nga një ndërmarrje tjetër, pjesë e marrëveshjes dhe ia ofron mallrat/shërbimet e kontraktuara tek një ndërmarrje e tretë, (po ashtu pjesë e marrëveshjes), pjesa e tregut të ndërmarrjes së parë, (qoftë në rolin e blerësit dhe furnizuesit), duhet të moskalojë kufirin e pjesës së tregut të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, me qëllim që të përfitohet nga përjashtimi i parashikuar në nenin 3

Neni 5

Kufizimet specifike dhe rastet e përjashtimit të tyre

1. Përjashtimi i parashikuar në Nenin 3, nuk zbatohet për marrëveshjet vertikale të cilat, drejtpërdrejt, (ose tërthorazi), vetëm, (apo në kombinim me faktorë të tjerë nën ndikimin e palëve), kanë si synim të tyre:
 - a) Kufizimin e aftësisë së blerësit në përcaktimin e çmimit të tij të shitjes, por pa e hequr mundësinë për furnizuesin që t'i imponojë atij një cmim maksimal shitjeje, ose ti këshillojë një cmim shitjeje, me kushtin që ky i fundit të mos jetë i barabartë me një cmim minimal, ose të fiksuar nën efektin e presionit të ushtruar nga njëra prej palëve;
 - b) Kufizimin e shitjeve aktive, ose pasive, tek konsumatori përfundimtar, prej pjesëmarrësve të përzgjedhur të rjetit shpërndarës, të cilët veprojnë në nivelin e shitjes me pakicë;
 - c) Kufizimin, në kuadër të një marrëveshjeje midis furnizuesit të pjesëve përbërëse të një malli dhe blerësit të tyre që i përdor ato pjesë (detale) për prodhimin e pajisjes përfundimtare, e mundësisë së furnizuesit për shitjen e këtyre përbërësve, (po kështu edhe pjesëve të lidhura me to) tek përdoruesit përfundimtarë, riparuesit, ose të tjerë ushtrues të këtyre shërbimeve, të cilët nuk kanë qenë lejuar prej blerësit për

riparimin, ose mirëmbajtjen e këtyre paisjeve. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, kufizohet mundësia e ofruesit për t'i shitur këto pjesë përbërëse drejtpërdrejt tek konsumatori përfundimtar, ose te riparuesit, duke sjellë një përqëndrim të tregut;

- d) Kufizimin e furnizimeve të kryqëzuara ndërmjet shpërndarësve brenda një rrjeti të përzgjedhur shpërndarjeje, i cili përfshin shpërndarësit në nivele të ndryshme tregtimi.
- e) Kufizimin e territorit, ose të konsumatorëve, mbi të cilin/ët njëri blerës, palë në marrëveshje, mund të shesë mallrat/shërbimet e kontraktuara, pa shkaktuar një kufizim në vendin e selisë së tij;

2. Përjashtimi i parashikuar në Nenin 3, do të zbatohet edhe për rastet e kufizimeve të kufizimit specifik të mësipërm dhe konkretisht të përcaktuar në pikën 1, germa e, të këtij neni.

Kjo për shkak të rritjes së konkurrencës në tregje në situatat e mëposhtme dhe sidomos kur bëhet fjalë për të kufizuar:

-i. Shitjet aktive në një territor ekskluziv, ose tek një grup klientësh ekskluziv për furnizuesin, ose të caktuar nga furnizuesi tek një blerës tjetër, kur ky kufizim nuk limiton shitjet e klientëve të blerësit,

-ii. Shitjet e një **blerësi që vepron në tregun e shumicës** tek përdoruesit e tij;

-iii. Shitjet, nga pjesëmarrësit e një rrjeti të shpërndarësve të përzgjedhur, tek **shpërndarësit e paautorizuar**, në një territor që furnizuesi e ka rezervuar vetëm për veprimet e këtij rrjeti; si dhe për t'i

-iv. kufizuar aftësinë një blerësi, në shitjen e pjesëve përbërëse të destinuara për bashkimin përfundimtar të tyre prej klientëve, që mund ti përdorin ato për prodhimin e paisjeve analoge me ato të prodhuara nga furnizuese.

Neni 6

Kufizimet e përjashtuara

1. Përjashtimi në bllok, i parashikuar në Nenin 3, nuk zbatohet ndaj detyrimeve (edhe kur këto janë të përfshira në një marrëveshje vertikale) si ato vijueset:

- a) kur hasen detyrime të drejtpërdrejta, (apo te tërthorta), jo-konkurrese, kohëzgjatja e të cilave është e pacaktuar, ose i tejkalon pesë vjet;

Në kuptim të dispozitës së mësipërme, të këtij neni, në një detyrim jo-konkurrese, i cili është rinovuar në heshtje, periudha mbi pesë vjet do të prezumohet sikur ka qenë e caktuar për një kohëzgjatje të pacaktuar.

- b) kur hasen detyrime të drejtpërdrejta, (apo të tërthorta), të cilat i ndalojnë blerësit (pas përfundimit të marrëveshjes) prodhimin, blerjen, shitjen, apo rishitjen e mallrave/shërbimeve;
- c) kur hasen detyrime të drejtpërdrejta, (apo të tërthorta) që u imponojnë anëtarëve të një rrjeti të përzgjedhur shpërndarjeje, ndalim të shitjes së markave të furnizuesve konkurrentë dhe të përcaktuar.

2. Pavarësisht pikës 1, germa **a**, kufizimi kohor prej pesë vjetësh nuk do të zbatohet kur produktet e kontratës të jenë shitur nga blerësi nisur nga lokalet dhe terreni pronar i të cilave është furnizuesi, ose të marra me qira nga furnizuesi, nëpërmjet palëve të treta, që nuk kanë lidhje me blerësin, me kusht që kohëzgjatja e detyrimit jo-konkurrues të mos e kalojë periudhën e shfrytëzimit nga blerësi të ambienteve dhe tokës nga blerësi.
3. Pavarësisht paragrafit 1 (b), përjashtimi i parashikuar në nenin 3, duhet të zbatohet edhe për çdo detyrim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që i ndalon blerësit (pas përfundimit të marrëveshjes), prodhimin, blerjen, shitjen, apo rishitjen e mallrave/shërbimeve, kur detyrimet kanë përmbushur kushtet e mëposhtme:
 - a) detyrimi që ka të bëjë me produkte, të cilat konkurrojnë me produktet e kontraktuara;
 - b) detyrimi është i kufizuar në ambientet dhe në terrenin mbi të cilat blerësi ka ushtruar aktivitetet përgjatë periudhës së kontratës;
 - c) detyrimi është i domosdoshëm për të mbrojtur njohuritë know-how, që transferohen nga furnizuesi tek blerësi;
 - d) kohëzgjatja e detyrimit është e kufizuar për një periudhë prej një viti pas përfundimit të marrëveshjes.

Neni 7

Moszbatimi i kësaj Rregulloreje

Kjo Rregullore nuk do të zbatohet për marrëveshjet vertikale, të cilat përmbajnë kufizime të veçanta në lidhje me tregun, kur rrjetet paralele, të cilat përfshijnë kufizime vertikale të ngjashme me rastet e mësipërme, zotërojnë më shumë se 50% të atij tregu përkatës.

Marrëveshje të tilla, në mbështetje të neneve 5 dhe 49 të Ligjit Nr.9121, date 28.03.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurrencës”, duhet të njoftohen pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe të kërkohet prej tij përjashtimi individualisht i tyre.

Neni 8

Përlllogaritja dhe Zbatimi i kufirit të pjesës së Tregut

1. Për zbatimin e kufirit të pjesës së tregut të parashikuar në Nenin 4, do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

- a) pjesa e tregut të furnizuesit/ofruesit do të llogaritet në bazë të të dhënave të vlerës së shitjeve në treg dhe pjesa e tregut e blerësit, do të llogaritet në bazë të të dhënave të vlerës së blerjes në treg. Në qoftë se të dhënat e vlerës së shitjes ose të blerjes në treg nuk janë të disponueshme, mund të përdoren të dhëna të tjera të besueshme për të përcaktuar pjesën e tregut të ndërmarrjes përkatëse duke përfshirë dhe vëllimin e tregut të shitjes, apo vëllimin e blerjeve.
- b) pjesët e tregut do të llogariten mbi bazën e të dhënave që lidhen me vitin e paraardhës kalendarik;
- c) pjesa e tregut të furnizuesit duhet të përfshijë çdo mall/shërbim të ofruar për qëllime shitje, për shpërndarësit e integruar vertikalisht.
- d) në qoftë se një pjesë e tregut është fillimisht nën 30% dhe më pas rritet më lart se kjo përqindje, (por pa e tejkaluar masën e 35%), përjashtimi i parashikuar në nenin 3, do të vazhdojnë të zbatohet për një periudhë prej dy vitesh kalendarike të njëpasnjëshme, pas vitit në të cilin fillimisht kufiri prej 30% është tejkaluar për herë të parë;
- e) në qoftë se pjesa e tregut, fillimisht është jo më shumë se 30% por më pas rritet mbi 35%, përjashtimi i parashikuar në nenin 3, duhet të vazhdojë të zbatohet për një vit kalendarik, pas vitit në të cilin kufiri prej 35% është tejkaluar për herë të parë;
- f) përfitimi nga pikat (d) dhe (e) nuk mund të kombinohet në mënyrë të tillë që të tejkalohet periudha prej dy vitesh kalendarike.

Neni 9

- 1 Për qëllim të llogaritjes së xhiros totale vjetore sipas Nenit 3 (2), do të mblidhen së bashku xhiroja e arritur përgjatë vitit të kaluar financiar nga pala përkatëse në marrëveshje vertikale dhe xhiroja e arritur nga ndërmarrjet e lidhura, në lidhje me të gjitha produktet, duke përjashtuar të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera. Për këtë qëllim, nuk do të merret parasysh marrëdhënia ndërmjet palës në marrëveshje vertikale dhe ndërmarrjeve të lidhura me të, ose ndërmjet ndërmarrjeve të saj të lidhura.
2. Përjashtimi i parashikuar në nenin 3, do të zbatohet në rastet kur për një periudhë prej dy vitesh të njëpasnjëshëm financiar, kur xhiroja totale vjetore nuk e tejkalon pragun me më shumë se 10%.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.